



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 26 nëntor 2013**

**Numri i lëndës: 2013-20**

**Shaip Gashi**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 25 dhe 26 nëntor 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 11 korrik 2013.

## **II. FAKTET**

2. Faktet ashtu siç janë parashtruar nga ankuesi, mund të përmbliidhen si në vijim.
3. Më 31 korrik 2001, Organizata ndërkombëtare për Migrim (IOM) i ka dhënë ankuesit kompensim për punë të detyruar gjatë regjimit nazist në Gjermani në shumën prej 7600 eurosh (shtatë mijë e gjashtëqind eurosh). Kompensimi ishte dhënë si pjesë e Programit gjerman për kompensimin e punës së detyruar, të realizuar nga Fondacioni gjerman "Kujtim, Përgjegjësi dhe Ardhmëri". Programi ishte zbatuar në bashkëpunim me organizatat partnere, në mesin e të cilave ishte IOM-i.
4. Ankuesi pohon se kompensimi në para asnjëherë nuk kishte arritur tek ai dhe se ai kompensim ishte shpërdoruar. Ankesat e tij tek IOM-i dhe autoritetet gjermane kanë qenë të pasuksesshme.

## **III. ANKESAT**

5. Ankuesi pa përmendur ndonjë dispozitë të caktuar të mjeteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut pohon se janë shkelur të drejtat e tij ekonomike.

## **IV. LIGJI**

6. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të zbatuar mjetet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet demokratike ligjore.
7. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
9. Paneli konsideron se ankesa e parashtruesit të ankesës ka të bëjë me zbatimin e një vendimi të nxjerrë nga IOM-i, që lidhet me

kompensimin për punën e detyruar. Nuk është treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në këtë çështje.

10. Del se kjo ankesë bie jashtë kuadrit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe rrjedhimisht jashtë kompetencës së Panelit, siç është formular në rregullën 25 të rregullores së punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, gjen se ankesa është e pabazuar sipas nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese